



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.3. pikën a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Ejona" Sh.P.K. të datës 28.02.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 23.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 026 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Ejona" Sh.P.K. kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 026 211 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 23.02.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 026 211.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Ejona" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Ejona" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi) me datë 28.02.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 23.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 026 211.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë si në vijim:

1. **Pretendimi i parë** – tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar dëshminë lidhur me standardin SK EN ISO 9001 siç është kërkuar me dosjen e tenderit.
2. **Pretendimi i dytë** – tenderuesi i rekomanduar nuk ka sigurim të tenderit siç është kërkuar me dosjen e tenderit.
3. **Pretendimi i tretë** – tenderuesi i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë profesionale siç është kërkuar me dosjen e tenderit pasi që nuk ka ofruar dëshmi se ka të punësuar së paku tri (3) ekipe me nga dy (2) teknikë me nga minimumi tri (3) përvojë të punës përkatëse apo punë të ngjashme.
4. **Pretendimi i katërt** – tenderuesi i rekomanduar ka shkelur deklaratën nën betim.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 66 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”) si dhe me nenin 26, 28 dhe 38 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”).

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”), autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 07.03.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimet numër një (1), dy (2) dhe katër (4) janë të pabazuara në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nën paragrafi d) të RRPP. Njëkohësisht është gjetur se pretendimi me numër tre (3) i parashtruesit është i bazuar në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1. nën paragrafi 63.1.2. të RRPP.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar si prova Njoftimi për kontratë, oferta e tenderuesit të rekomanduar, letra standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit drejtuar tenderuesit të rekomanduar, përgjigja e tenderuesit të rekomanduar në kërkesën për sqarimin e tenderit, raporti i vlerësimit nga komisioni vlerësues si dhe njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues.

Sa i përket pretendimeve me numër një (1), dy (2), dhe katër (4), pas analizimit të tyre është gjetur se lidhur me këto pretendime parashtruesi nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme. Rrjedhimisht këto pretendime si të tilla janë të pabazuara pasi që nga dosja e tenderit mund të vërtetohet e kundërta e tyre sipas elaborimeve në vijim:

- **Sa i përket pretendimit numër një (1)**, nga dosja e ofertës së tenderuesit të rekomanduar mund të vërtetohet se është dorëzuar çertifikata SK EN ISO 9001 siç është kërkuar me dosjen e tenderit. Për këtë arsye ky pretendim është i pabazuar.
- **Sa i përket pretendimit numër dy (2)**, nga dosja e ofertës së tenderuesit të rekomanduar mund të vërtetohet se është ofruar sigurimi i tenderit sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Prandaj ky pretendim është i pabazuar.
- **Sa i përket pretendimit numër katër (4)**, parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi apo argument të qëndrueshëm për të vërtetuar se tenderuesi i rekomanduar ka shkelur deklaratën nën betim siç pretendohet. Për këtë arsye ky pretendim është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit numër tre (3) është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente dhe dëshmi të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Rrjedhimisht ky pretendim është i bazuar sipas elaborimeve në vijim:

- **Sa i përket pretendimit numër tre (3)**, fillimisht duhet theksuar se në njoftimin për kontratë të datës 30.03.2022 në rubrikën III)2.4. lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional është përcaktuar si në vijim *“2.Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme a.Inxhinier i diplomuar ose bachelor i elektroteknikes. Minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë menaxhuar së paku 1 kontrata të natyrës së ngjashme. b.Inxhinier i diplomuar ose bachelor i makinerisë. Minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë menaxhuar së paku 1 kontrata të natyrës së ngjashme. c. 3 ekiye me nga 2 teknikë. Minimumi 3 vite përvojë pune në punë të ngjashme”*. Me datë 17.08.2022 autoriteti kontraktues ka kërkuar nga tenderuesi i rekomanduar që bazuar në nenin 72 të LPP të dorëzoj dokumentacion shtesë lidhur me përvojën e punës për së paku gjashtë (6) teknikët që duhet të ketë angazhuar. Brenda afatit të përcaktuar, tenderuesi i rekomanduar është përgjigjur në kërkesën e autoritetit kontraktues duke dorëzuar si dokumentacion shtesë pasqyrën e trustit, biografite (CV) dhe diplomat e shkollimit për punonjësit vijues 1. *Fatos Maloku*; 2. *Arbër Sadiku*; 3. *Ardian Ferizi*; 4. *Fatmir Berisha*; 5. *Luan Makolli*; 6. *Xhevdet Pajaziti*, dhe 7. *Elton Salihaj* dhe 8. *Arian Kosumi*. Pas analizimit të pasqyrave të trustit që ka dorëzuar vet tenderuesi i rekomanduar, rezulton se vetëm katër (4) punonjës kanë përvojë të punës mbi tri (3) vite (*Fatos Maloku; Arbër Sadiku; Ardian Ferizi; Fatmir Berisha*). Ndërsa katër (4) punonjësit tjerë kanë dukshëm më pak se tri (3) vite përvojë të punës sikurse në vijim: *Luan Makolli (27 muaj); Xhevdet Pajaziti (16 muaj); Elton Salihaj (18 muaj); Arian Kosumi (nuk ka dorëzuar fare pasqyrën e trustit)*. Sa i përket biografive duhet theksuar se nga CV-të e punonjësve *Ardian Ferizi; Luan Makolli dhe Arian Kosumi* nuk mund të identifikohet saktë përvoja e tyre e punës pasi që ata kanë vendosur vetëm vitet kur kanë filluar/përfunduar një marrëdhënie të punës por jo edhe datat e sakta përmes të cilave do të mund të evidentoj saktë përvoja e punës në vite, muaj dhe ditë. Kjo e ka bërë të pamundur të kuantifikohet saktësisht përvoja e punës për këta punonjës tre punonjës: *Ardian Ferizi; Luan Makolli dhe Arian Kosumi*.

Me fjalë të tjera sipas pasqyrave të trustit rezulton se vetëm katër (4) teknikë kanë mbi tri (3) vite përvojë të punës (Fatos Maloku; Arbër Sadiku; Ardian Ferizi; Fatmir Berisha). Ndërsa sipas kriterit të biografisë (CV) rezulton se vetëm pesë (5) teknikë kanë arritur të dëshmojnë përvojën e tyre të saktë të punës në vite, muaj dhe ditë (Fatos Maloku; Arbër Sadiku; Fatmir Berisha; Xhevdet Pajaziti; Elton Salihaj). Mirëpo në asnjërin rast nuk është arritur të dëshmohet se janë angazhuar gjashtë (6) punonjës me nga së paku tri (3) vite përvojës të punës. Përndryshe në raportin e vlerësimit nuk evidentohet asnjë sqarim nëse përvoja e punës së teknikë është përvojë e punës si teknike apo përvojë e ngjashme e punës apo është përvojë në ndonjë natyrë tjetër të punës që mund të mos jetë relevant për këtë aktivitet të prokurimit.

Rrjedhimisht sipas dokumenteve që ka dorëzuar vet tenderuesi i rekomanduar, nuk është arritur të dëshmohet se janë angazhuar gjashtë (6) teknikë me nga tri (3) vite përvojë të punës siç është kërkuar me dosjen e tenderit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parashtruesit me numër tre (3) është pretendim i bazuar.

Për pikën I të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në 7 të LPP lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.3. pikën a) të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.03.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.